



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI

VENDIM

Nr. 70 date 31.10.2024

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË BASHKISË PËR FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE PËR MUAJIN TETOR 01-31.10.2024.

Në bazë të Ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, vendimit Nr 85 datë 10.02.2021, si dhe bazuar në Udhëzimi nr.4 datë 17.02.2017 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pika 7, Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligjit 68/2017 “Mbi Financat e Vetëqeverisjes Vendore” VKB nr. 113 datë, 14.12.2023 për “Për Miratimin Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe Buxhetit Vjetor 2024” është miratuar fond “Ndihma Ekonomike” me fond limit 1.800.000 lekë/ vit, Këshilli i Bashkisë Gjirokastrë.

VENDOSI :

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Tetor 2024, 41 individë/ familje me fond 125,433 lekë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, (Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Shoqërore), si dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I KËSHILLIT
Etleva YZO

KRYETARI I KËSHILLIT
Merita ISARAJ

